

## **RIKLASIFIKIMI I PËRGJITHSHËM (DALJE) NGA ESL**

I dashur Prind / Kujdestar,

Ju po e merrni këtë letër sepse aftësia e gjuhës angleze e fëmijës suaj është përmirësuar. Si i tillë, fëmija juaj **mund** të jetë një kandidat i mirë për riklasifikim (dalje) nga programi (ESL), anglishtja si një gjuhë e dytë.

Në mënyrë që të kualifikohen për riklasifikim (dalje) nga ESL, nxënësit duhet të arrijnë një nivel **4.5 ose më lart në testin e ACCESS, të vitit 2020**. Prandaj, është shumë e rëndësishme që fëmija juaj të bëjë provimin, i cili do të administrohet në shkollën e fëmijes tuaj diku midis 6 Janarit dhe 21 Shkurtit 2020.

Vendimet e riklasifikimit varen gjithashtu nga kontributi i mësuesve. Në mënyrë të veçantë, mësuesit në shkollën tonë do të vlerësojnë aftësitë e fëmijës suaj në gjuhën anglishte nga koha e tanishme deri në Prill të vitit 2020. Nëse mësuesit e fëmijës suaj përcaktojnë se ai **ka aftësi të mjaftueshme të gjuhës Angleze** për të pasur sukses në shkollë pa mbështetjen e ESL, dhe ka arritur nivelin 4.5 ose më lart në provimin ACCESS të vitit 2020, ai mund të riklasifikohet.

Nëse fëmija juaj është riklasifikuar, ai nuk do të ketë më të drejtë të marrë mbështetje të drejtpërdrejtë nga një mësues i ESL. Në vend të kësaj, fëmija juaj do të marrë vetëm mbështetje të përgjithshme nga mësuesit, dhe performanca e tij / saj akademike do të vazhdojë të monitorohet.

Qëllimi i kësaj letre është t'ju japë informacione rreth procesit të riklasifikimit dhe **nuk do të thotë** që fëmija juaj është riklasifikuar. Rezultatet e ACCESS do të ndahen me ju në Qershor 2020, dhe vendimet përfundimtare për riklasifikimin do të ndahen me ju në Tetor 2020. Ndryshimet në shërbimet ESL nuk do të fillojnë deri në vitin shkollor 2020-21.

Ju lutem më kontaktoni me ndonjë pyetje.

Sinqerisht,

Emri: \_\_\_\_\_

Roli: \_\_\_\_\_

Email: \_\_\_\_\_

Telefon: \_\_\_\_\_

## **PYETJE MË TË SHPESHTA**

### **1. Çfarë do të thotë të jesh një nxënës i gjuhës Angleze (EL )?**

Nxënësi i gjuhës Angleze (EL) është identifikuar si i tille sepse ka nevojë për shërbime gjuhësore ( angleze), të cilat ofrohen përmes Programit të Arsimit të Gjuhës (LIEP), i njohur zakonisht si Anglishtja si Gjuhë e Dytë (ESL).

### **2. Cila është saktësisht qëllimi i programit ESL?**

Qëllimi i programit të gjuhës Angleze si gjuhë e dytë (ESL) është që të ndihmojë fëmijën tuaj të mësojë gjuhën angleze në mënyrë që ai të jetë në gjendje të kuptojë mësimet e përditshme, të marrë pjesë në mënyrë shoqërore në shkollë dhe të plotësojë standartet akademike të përshtatshme për kalimin e klasës dhe diplomimin .

### **3. Si u identifikua fëmija im si EL nxënës?**

Kur prindërit / kujdestarët e regjistrojnë fëmijën e tyre në shkollë, ata plotësojnë një pyetësor " Home Language Survey". Bazuar në përgjigjet e pyetësorit, fëmija juaj do të bëjë një provim në anglisht, dhe në bazë të aftësive, të rezultateve fëmija juaj do të përcaktohet nëse ai / ajo ka nevojë për shërbime në gjuhën angleze. Ky vlerësim quhet WIDA Screener dhe përdoret me nxënësit në klasat K-12.

### **4. Çfarë është provimi ACCESS?**

ACCESS për EL është një provim që mat aftësinë e fëmijës suaj në anglisht. Ky provim jepet midis Janarit dhe Shkurtit të çdo viti shkollor dhe administrohet nëpërmjet kompjuterit ose me letër dhe laps. Nxënësit marrin një rezultat prej 1.0 - 6.0 (6.0 është më i larti).

### **5. Çfarë testohet në provimin ACCESS?**

ACCESS mat aftësitë angleze të nxënësve në lexim, shkrim, të folur dhe dëgjim. Këto fusha zakonisht quhen "domains". Çdo fushë gjeneron një rezultat i cili, i marrë së bashku, prodhon një rezultat të përgjithshëm të përbërë, i njohur gjithashtu si niveli i aftësive angleze të fëmijës suaj.

### **6. Çfarë do të thotë të riklasifikohet (dalë) nga ESL?**

Nxënësit janë riklasifikuar kur dëshmitë (rezultatet e provimit ACCESS dhe rekomandimet nga mësuesit) tregojnë se fëmija është i aftë në gjuhën angleze. Pas riklasifikimit të nxënësve, performanca e tyre akademike monitorohet për katër (4) vjet. Nëse përcaktohet gjatë fazës së monitorimit se fëmija nuk përparon akademikisht si rezultat i barrierës gjuhësore në mënyrë të vazhdueshme, atëherë fëmija do të ri-përcaktohet si një nxënës aktiv i gjuhës Angleze dhe do të ri-regjistrohet në Anglisht si Program i Gjuhës së Dytë (ESL).

**7. Si e dini nëse fëmija im është një kandidat i mirë për riklasifikim?**

Nëse fëmija juaj është i barabartë ose afër nivelit të aftë të përcaktuar të gjuhës angleze (niveli ACCESS prej 4.5 ose më lart), dhe po përparon drejt përmbushjes së standarteve të niveleve të duhura, ai mund të jetë një kandidat i mirë për riklasifikim.

**8. A do të vazhdojë fëmija im të marrë shërbime gjuhësore (angleze) nëse ai / ajo riklasifikohet?**

Nxënësi do të marrë shërbime të përgjithshme nga mësuesit, por nuk do të marrë mësimin e gjuhës angleze që është bazuar në udhëzimet, Anglishtja si gjuhë e dytë.

**9. Ku mund të mësoj më shumë për procesin e riklasifikimit?**

Ju mund t'i shikoni kriteret për riklasifikim në faqen e internetit të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë në <https://www.education.pa.gov/>. Pasi të keni vizituar faqen e internetit, kërkoni dokumentin me titull "Reclassification, Monitoring and Redesignation of EL-s"